Gazetë Bashkia Patos

www.bashkiapatos.gov.al Gazeta e qytetarit te Patosit 1 Prill 2017

Në kuadër të nxitjes së ndërgjegjësimit qytetar për pjesëmarrjen në vendimmarrje, stafi i IDRA (Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi) po zbaton aktualisht projektin "Zhvillimi i Qasjeve Inovative për përfshirjen e Komuniteteve në Qeverisjen Vendore" me mbështetjen financiare të Lëviz Albania. Në kuadër të këtij projekti, me qëllim prezantimin dhe përditësimin mbi risitë e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen lokale u zhvillua aktiviteti "Trajnimi i trajnerëve" ku morrën pjesë nga Bashkia Patos, Esmeralda Kararaj dhe Blerina Aledini. Në vijueshmëri të nxitjes së ndërgjegjësimit qytetar për pjesëmarrjen në vendimmarrje, në datën 27 Mars 2017, në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak të Bashkisë Patos, u realizua takimi studimor me dy përfaqësueset e përzgjedhura nga IDRA për zhvillimin e këtij seminari, si dhe me përfaqësues të administratës të Bashkisë Patos.

Në takim morën pjesë 10 përfaqësues në pozicione tilla si: Specialist dhe drejtues të zyrës së informacionit, specialistja e financës, specialist i urbanistikës, specialistja e zyrës së barazisë gjinore dhe dhunës në familje, juristja e Drejtorisë së Legjislacionit, anëtare e Këshillit Bashkiak dhe përfaqësuesi i komisionit këshillimor qytetar vendor. Në seminar referuan znj.Esmeralda Kararaj dhe znj.Blerina Halidini, të cilat u trajnuan në seminarin dy ditor "Trajnimi i trajnerëve për përfshirjen e Komuniteteve në Qeverisjen Vendore" të zhvilluar nga IDRA në Tiranë. Gjatë referimit u prezantuan "***Mekanizmat për pjesëmarrjen qytetare në ndihmë të vendimmarrjes së pushtetit lokal***" dhe ***"Kuadri ligjor i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje"***.

Krahas këtyre fakteve dhe rëndësisë së trajnimit si përfundim mund të themi: Duke u njohur tashmë me rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, Bashkia Patos, në vazhdimësi ka intensifikuar së tepërmi komunikimin drejtpërdrejt, nëpërmjet takimeve publike me grupet e interesit për çdo investim që realizon.

Takim me gratë e Njësisë Administrative

Specialistja e Zyrës së Barazisë Gjinore Esmeralda Velmishi ka zhvilluar një takim në ambientet e Njësisë Administrative Zharrëz. Takimi informues sensibilizues u realizua në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Fier dhe fondacionin Mary Ward Loreto me gratë e kësaj njësie. Fuqizimi social-ekonomik dhe kujdesi shëndetësor ishte fokusi, takime të tjera do të vijojnë duke trajtuar tematika të ndryshme.

Kompania Patient & Creation, ideuar në kuadër të Junior Achievement Albania, ka fituar vendin e parë në Panairin Rajonal të Zhvillimit në Gjirokastër.

Nxënësit e përkushtuar të Gjimnazit “Zhani Ciko” nën udhëheqjen e mësuese Mbaresa Marku me mbështetjen e drejtoreshës së shkollës Zamira Velçani, ndanë me Kryebashkiaken Balilaj emocionet e fitores së konkursit në nivel kombëtar dhe e falenderuan për mbështetjen dhe nxitjen e nismave dhe aktiviteteve rinore.

Pranë lapidarit në Margëlliç është zhvilluar përkujtimi i 73 vjetorit të Betejës së Margëlliçit, si ngjarja më e rëndësishme historike e qytetit.

Nderojmë Heronjtë dhe Dëshmorët e Atdheut që luftuan dhe ranë në Betejën e përgjakshme për marrjen e Kalasë së Margëlliçit. Edhe pse kanë kaluar 73vjet nga kjo ngjarje historike më e rëndësishmja e zonës sonë, heroizmi dhe sakrifica e Heronjve Mustafa Matohiti, Meleq Gosnishti, Lefter Talo dhe Dëshmorëve Damin Koro, Lufti Tolari, Hajrulla Papa, Faik Çarogunji, Stefan Zhaka, Abedin Shkëmbi, Ndreko Zhaka që vinin nga krahina të ndryshme të Shqipërisë: Tepelena, Përmeti e Saranda dhe Mikele Trali e Josif Vadoviç nga shtete të tjera Italia e Jugosllavia, përkujtohen me nderim dhe respekt nga Bashkia Patos, Organizatat e Veteranëve dhe Familjeve të Dëshmorëve,shoqatat atdhetare, mësues e nxënës të shkollave dhe qytetarë të Patosit. Kryebashkiakja Balilaj shprehu vlerësimin maksimal për figurat që kontribuan në Luftën për Çlirimin e Vendit dhe vlerësoi rëndësinë që ka përkujtimi i këtyre ngjarjeve, si vlerë që krenon çdo brez dhe mbetet panteoni i lirisë së qytetit. Deputetja e zonës znj.Antoneta Dhima, Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të Veteranëve të LANC z.Odise Porodini dhe Kryetari i Veteranëve të qytetit z.Harun Nazëraj, mbajtën fjalën e rastit duke shprehur vlerësime dhe nderime për figurën e dëshmorëve dhe kësaj ngjarje me jehonë kombëtare. Në lapidarin e Margëlliçit, simbolin e betejës më të madhe të këtij trungu mijëravjeçarë,

Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj shprehu mirënjohjen dhe respektin për sakrificën njerëzore dhe gjakun e derdhur për liri. Nxënësit e shkollës "Mustafa Matohiti" interpretuan këngë dhe poezi patriotike kushtuar bijve që dhanë jetën në moshën më të bukur të tyre. Prej disa vitesh përkujtimi i kësaj ngjarje historike i është rikthyer traditës së vjetër aty ku luftuan dhe dhanë jetën Heronjtë dhe Dëshmorët, në Kalanë e Margëlliçit.

Qendra Kulturore e Fëmijëve, simpozium në kuadër të 73 Vjetorit të Betejës së Margëlliçit!

Në kuadër të 73-vjetorit të Betejës së Margëlliçit, Qendra Kulturore e Fëmijëve organizoi në Pallatin e Kulturës aktivitetin **"Patosi-Vendlindja ime!"**

Fëmijët e qendrës kulturore të kurseve të paradites përkujtuan në aktivitetin historiko kulturor, historikun dhe figurat patriotike të qytetit, recituan vjersha për dëshmorët si dhe realizuan pjesë dramatizimi legjendën "Ymer Aga". Fjalimet përshëndetëse nga Kryetarët e Shoqatave të Veteranëve dhe Familjeve të Dëshmorëve përmbyllën aktivitetin, i cili është kthyer në traditë, duke sjellë në vëmendjen e pasardhësve të qytetit vlerat historike.

Transparencë për qytetarët

NJOFTIM!

Ditën e martë dt. 28.03.2017 ora 14:^{00} në sallën e mbledhjeve pranë Bashkisë u zhvillua mbledhja e Këshillit Bashkiak me këtë rend dite:

1. Miratimi i ndihmave ekonomike për periudhën mars 2017
2. Miratimi i projekt-vendimit, "Për disa ndryshime në nivelin e pagave për personelin edukativ, ndihmës parashkollor dhe parauniversitar për vitin 2017".
3. Miratimi i projekt-vendimit, "Për disa ndryshime në nivelin e pagave për Administratën, Arsim Kulturën, Njësinë Administrative Zharrëz dhe punonjësit e kullimit të Bashkisë për vitin 2017".
4. Miratimi i projekt-vendimit , "Për disa ndryshime në nivelin e pagave për Ndërmarrjen e Rregullim Territorit për vitin 2017".
5. Miratimi i projekt-vendimit, "Për kalimin në pronësi dhe përdorim të përfituesve të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në lagjen Mustafa Matohiti".
6. Miratimi i projekt-vendimit "Për kalimin në pronësi të përftuesve të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore për fshatin Grizë Lënginas".
7. Miratimi i projekt-vendimit, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore për fshatin Banaj".
8. Informacion nga ekzekutivi i Bashkisë "Për situatën e investimeve gjatë vitit 2017".
9. Të ndryshme.

Ju rikujtojmë se mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura dhe ju inkurajojmë të merrni pjesë.

Një qytetar i informuar, është padyshim një qytetar më i mirë!